



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 844/4 prot.

Tiranë më 30.07.2020

VENDIM

Nr. 34, datë 30.07.2020

PËR KONTROLLUESIN “TSTS Group” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77 - 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “TSTS Group” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. nr.126, datë 16.07.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga z. D. T në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar .

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi ka si objekt të veprimtarisë tregtare, ndër të tjera, ofrimin e “[...] e kurseve të trajnimit profesional në sektorin detar (Certifikime STCW); trajnim për aftësimin në drejtimin e mjeteve të vogla lundruese (Skipper); kurse trajnimit dhe certifikim për sigurinë dhe shëndetin në punë; agjenci formimi dhe ndërmjetësimi në tregun e punës (Ekuipazhe Detare dhe Personel), brenda dhe jashtë vendit etj.”.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “punëmarrës”, “punëmarrës të larguar”, “person kontakti që ka lidhje me aplikantët për punë”, “aplikantë për punë” dhe “studentë”. Të dhënat përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet mjeteve elektronike.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur nga subjekti i të dhënave personale D. T., rezultoi se:

Kontrolluesi publikon në faqen [www.crew.al](http://www.crew.al), formularët e aplikimit të subjekteve të të dhënave personale (*studentë*), të cilët zhvillojnë trajnime pranë tij. Të dhënat e publikuara janë “*emër, mbiemër, fotografi, numri i pasaportës, adresa, numri i telefonit, adresë, etj.*”.

Ankuesi, nëpërmjet e-mailit në datë 22.05.2018, ka kërkuar fshirjen e të dhënave të tij të publikuara në faqen e internetit të Kontrolluesit.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për fshirjen e të dhënave të ankuesit pas marrjes së kërkesës, si dhe nuk e ka informuar atë për kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo fshirjen, në kundërshtim me parashikimet e sanksionuara në nenet 5, 13 dhe 19 të Ligjit.

Në formularin e plotësuar nga ankuesi, nuk rezulton që Kontrolluesi të ketë informuar subjektin e të dhënave apo të ketë siguruar marrjen e pëlqimit për publikimin e të dhënave të tij, në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 dhe 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se e drejta për të kërkuar fshirjen e të dhënave është një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit, për të kërkuar nga Kontrolluesi fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 19 të Ligjit, është detyrim i Kontrolluesit të kryej vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit.

3. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë veprimtarisë tregtare, u konstatua se Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat për kohën e ruajtjes së të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “*punonjës të larguar*” dhe “*studentë*” në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në germën “d” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë përpunuar të dhënat personale. Në momentin kur qëllimi i përpunimit ka përfunduar është e nevojshme që Kontrolluesi, vetë ose nëpërmjet delegimit të një palë e tretë në cilësinë e

përpunuesit, të realizojë shkatërrimin/fshirjen e të dhënave personale, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

4. Kontrolluesi në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë ka instaluar një sistem video survejimi (CCTV), të përbërë nga 12 kamera. Kontrolluesi nuk ka vendosur tabelë informuese, duke mos informuar subjektet e të dhënave për prezencën e sistemit të video survejimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18, të Ligjit dhe në Udhëzimit nr. 03, datë 05.03.2010, të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Kamerat janë pozicionuar në ambientet e brendshme ku ofrohet trajnimi, si dhe në ambientet e punës së punonjësve, në kundërshtim me parashikimet në Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privatë” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Kontrolluesi nuk ka vendosur politika privatësie në faqen e tij të internetit, [www.crew.al](http://www.crew.al), në kuadër të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2012, të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, si dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit, ka detyrimin të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes së internetit. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të Privatësisë” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- (i) Deklarimin në rubrikën 4 “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, për të dhënat numër telefoni, e-mail, fotografi;
- (ii) Deklarimin në rubrikën 7 “Marrësi i të dhënave Personale”, për të gjithë marrësit, subjekte publike dhe privatë, tek të cilat, Kontrolluesi, në zbatim të detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktore përhap të dhëna;

(iii) Deklarimin në rubrikën 10 “*Masat e sigurisë*”, për të cilën Kontrolluesi ka deklaruar se posedon një rregullore specifike, por gjatë inspektimit nuk paraqiti asnjë provë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

6. Kontrolluesi nuk disponon rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave (të punëmarrësve, punonjësve të larguar, kandidatëve për punë dhe vizitorëve), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektesh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla të brendshme specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3.

7. Gjatë hetimit administrativ Kontrolluesi pretendoi se dispononte edhe kontrata me palët e treta si “*Spitali SALUS*” dhe do i vinte në dispozicion të grupit të hetimit nëpërmjet e-mail-it të Zyrës së Komisionerit [info@idp.al](mailto:info@idp.al), por nuk u vunë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit.
8. Kontrolluesi nuk ka marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe vërehet mosplotësim i detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga dispozitat e Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit

*“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimi nr. 48”), si dhe është një sistem i certifikueshëm për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit 48.*

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe konfirmoi qëndrimin e mbajtur lidhur me kundërshtimin e procesverbalit të hetimit administrativ, të paraqitur nëpërmjet e-mail-it 29.07.2020.

Në vijim të shqyrtimit të kundërshtimeve të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

1. Në lidhje me pretendimin se formulari nuk ekziston në faqen e kontrolluesit, meqenëse është fshirë që më datë 10.05.2018, sqarojmë se nga verifikimi i kryer dhe provat e administruara nga Zyra e Komisionerit, më datë 16.07.2020, është e provuar se formulari i aplikimit të ankuesit është publikuar në faqen e internetit [www.crew.al](http://www.crew.al).
2. Sa i përket pretendimit se, në formularin e regjistrimit ankuesi ka autorizuar përdorimin e të dhënave personale me qëllim trajnimin dhe punësimin, sqarojmë se në formularin e plotësuar nga ankuesi, nuk rezulton që Kontrolluesi të ketë informuar këtë të fundit apo të ketë siguruar marrjen e pëlqimit të tij për publikimin e të dhënave personale në faqen e internetit [www.crew.al](http://www.crew.al).
3. Afati i ruajtjes së të dhënave të punonjësve dhe studentëve, duhet të specifikohet në rregullat e brendshme sipas detyrimeve të përcaktuara në germën “d” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 11, duke marrë parasysh edhe afatet e parashikuara, ndër të tjera, në legjisllacionin specifik që rregullon marrëdhëniet e punës.
4. Nga provat e administruara rezulton se Kontrolluesi nuk ka vendosur tabelë që ambienti survejohet sipas Udhëzimit nr. 3.
5. Në lidhje me pretendimin se ekziston një rregullore e brendshme, sqarojmë se nga ana e Kontrolluesit nuk i është vënë në dispozicion grupit të hetimit administrativ një rregullore ku parashikohen rregulla specifike për të gjitha proceset përpunuese që kryhen.
6. Në lidhje me pretendimin se marrëveshjet me palët e treta nuk janë vënë në dispozicion pasi janë konfidenciale, sqarojmë se Kontrolluesi ka detyrim

bashkëpunimin me Zyrën e Komisionerit duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim germave “a”, “b”, “c”, “d”, “dh” dhe “dh/1” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, si dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

*a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

*b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*

*c) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të korrigjuar ose fshirë të dhënat, të përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji, dënohen me 15 000 deri në 300 000 lekë;*

*d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

*dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

*dh/1) kontrolluesit dhe përpunuesit, që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë.*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ajo lidhet me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 13, 18, 19, 21, 27, 32, 29, 30, 39 (pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh” dhe “dh/1”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 19 të Ligjit;

3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për fshirjen e të dhënave të ankuesit në përputhje të detyrimit e përcaktuara në nenin 19 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje të detyrimit e përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
6. Kontrolluesi të ndalojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit të pozicionuar në ambientet e punës së punëmarrësve, si dhe të heqë kamerat e pozicionuara në zyrat e punonjësve referuar pozicioneve të cituara më sipër;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit të *“Politikave të Privatësisë”* në faqen e internetit, si dhe të marrë masa për përmbushjen në vijim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
8. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
9. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij, si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.  
  
SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, deponon pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;
10. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet e përcaktuara sipas këtij akti, brenda afateve si vijon:
  - (i) Menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikat 4 dhe 6 më sipër;
  - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 7 më sipër; dhe
  - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 9 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

11. Kontrolluesi “TSTS Group” të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
12. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
13. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 30.07.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

